

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE TIRANE  
ZYRA NOTERISE TIRANE  
Nr. 5386 REP.

PULLA E T  
APLIKUAR NE  
QENDI



### VERTETIM NENSHKRIMI

Sot me datën 28.12.2020, para meje noter Alket Z. Mancka, u paraqit personalisht deklaruesit para Zyres Noterise e ndodhur ne qytetin e Tirane rruga Asim Zeneli" Pll. Nr 10.

#### DEKLARUES:

- 1- **Z.JURGEN GORENCA**, shtetas shqiptar, lindur me 01.05.1991, lindur dhe banues ne Tirane, mbajtës i pasaportës me Nr.BD2943763 dhe Nr.Personal J10501104W, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, ne cilësinë e Administratorit dhe Ortakut te Shoqerise "Pegase" shpk.
- 2- **ZNJ.ADEA MEIDANI**, shtetase shqiptare, lindur me 27.04.1981, ne France, banuese ne Demeurant 145 Avenue Malakoof, France, e pajisur me pasaporte francize me Nr.17AV91783 madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, ne cilësinë e Ortakes se Shoqerise "Pegase" shpk, perfaqesuar Prokure te Apostiluar, date 09.12.2020 nga **Z.JURGEN GORENCA**, shtetas shqiptar, lindur me 01.05.1991, lindur dhe banues ne Tirane, mbajtës i pasaportës me Nr.BD2943763 dhe Nr.Personal J10501104W, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Deklaruesit jane madhore dhe te afte per te kryer veprime juridike, te panjohur prej meje personalisht, te cilet nenshkruan para meje Akt Themelimi i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar te Shoqerise "Pegase" shpk date 28.12.2020 dhe Statut i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar te Shoqerise "Pegase" shpk date 28.12.2020, bashkangjitur ketij vertetimi dhe une noteri e vertetoj ate ne baze te ligjit.

Une, Noteri, bej te ditur se permbajtja e ketij dokumenti nuk analizohet nga noteri.

Une, Noteri, e vertetoj autenticitetin e nenshkrimin, me cilësinë qe me njeni 55 i Ligjit Nr.7829 date 01.06.1994 "Per Noterine".

NOTER  
ALKET Z. MANCKA



**AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"PEGASE" Sh.p.k.**

Sot, më datë 28/12/2020, në Tiranë, u paraqitën palët e mëposhtme:

- **Z. Jurgen Gorenca**, shtetas shqiptar, lindur me 01.05.1991, ne Tirane, banues ne Rrugen Besim Imami nr 86, Tirana, Shqiperi, mbajtës i pasaportës me Nr. BD2943763 dhe Nr. Personal J10501104W, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar;  
dhe
- **Znj. Adea Meidani**, shtetase shqiptare, lindur me 27.04.1981, ne France, banuese ne Demeurant 145 Avenue Malakoof, France, e pajisur me pasaporte me Nr.17AV91783, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, e perfaqesuar per nenshkrimin e akteve nga Z. Jurgen Gorenca, sipas Prokures se Posacme, date 09.12.2020, bashkelidhur ketij akti.

të cilët kanë vendosur të nënshkruajnë Aktin e Themelimit të mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë "**Shoqëria**"), aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi, ligji nr. 9901, datë 14 prill 2008 "**Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare**", i ndryshuar dhe Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij akti, bashkëngjitur (më poshtë "**Shtojca 1**").

**Neni 1 - Emërtimi**

- 1.1 Emërtimi i Shoqërisë është "PEGASE" Sh.p.k.

**Neni 2 - Selia**

- 2.1 Selia e Shoqërisë është Rruga Themistokli Germenji, Njesia bashkiake nr.2, perballe RTSH, kati I, Tirane Shqiperi.

**Neni 3 - Kohëzgjatja**

- 3.1 Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar.

**Neni 4 – Objekti i shoqërisë**

- 4.1 Shoqëria ushtron aktivitetin e saj ne fushen e konsulences, kryesisht në tre drejtime kryesore; ndermjetesime me karakter te ndryshem; konsulence juridike dhe teknike si dhe asistencë në projekte kundrejt subjekteve te ndryshme, qofshin ato ente publike, private, organizata noqeveritare apo entitete te huaja. Shoqëria do te jape konsulencës juridike në lidhje me çdo problematikë eventuale, në kuadër të specifikimit të kuadrit ligjor, pavarisist fushes konkrete. Konsulenca ne fjale do te shtrihet edhe ne fushën e legjisLacionit fiskal, tatimor, doganor, duke perfshire përgatitjen e dokumentacionit, ndjekjen e të gjitha procedurave për regjistrim të shoqërive deri në dhënien e liçensës nga organi përkatës për fillimin e ushtrimit të aktivitetit;
- 4.2 Per me teper, konsulenca juridike do te perfshije edhe marrëdhëniet tregtare, përpilim dhe depozitim dokumentesh të shoqërive tregtare të regjistruara si subjekte të së drejtës shqiptare apo të huaj; Konsulencë në distancë dhe me anë të përfaqësuesve të brendshëm; perfaqesim dhe orientimin e klientit për zgjidhjen gjyqësore të konflikteve; implementim në bashkëpunim me ente te tjera te projekteve në fushën e së drejtës që lidhen me përmirësimin e legjislacionit, asistencë në aplikimin e së drejtës, funksionimin e strukturave të dhënies së drejtësisë etj; Përfaqësimin dhe mbrojtjen ligjore të personave fizik dhe juridik, vendas apo të huaj, private apo publikë, vendas apo të huaj, për çdo procedim administrativ, gjyqësor, jashtëgjyqësor, ekzekutimi të vendimeve gjyqësore etj. konform rregullave të parashikuara në legjisLacionin në fuqi. Shoqëria mund të ushtrojë çdo lloji tjetër veprimtarie të lejueshme nga legjislacioni në fuqi si dhe të marrë pjesë në procedurat e prokurimeve publike dhe konçensioneve.

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_



## Neni 5 – Kapitali themeltar

- 5.1 Kapitali themeltar fillestar i Shoqërisë është 100 Lekë.
- 5.2 Kapitali themeltar i Shoqërisë përbëhet nga 2 kuota, i gjithi i nënshkruar dhe i paguar, me vlerë nominale sipas kontributit të ortakëve në kapitalin themeltar të Shoqërisë, përcaktuar në nenin 7 të Statutit.

## Neni 6 - Kontributet

- 4.1 Kontributi në kapitalin e Shoqërisë është ofruar si më poshtë:
- Ortaku themelues: Adea Meidani zotërues e një (1) kuote me vlerë të barabartë me 90 Lekë që përbën 90 % (nentedhete përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë;
  - Ortaku themelues Jurgen Gorenca zotërues e një (1) kuote me vlerë të barabartë me 10 Lekë që përbën 10% (dhjete përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.

## Neni 7 – Transferimi i kuotave

- 7.1 Kuotat i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të vetë Statutit.

## Neni 8 – Administrimi

- 8.1 Me këtë akt emërohet 1 (një) Administrator i Shoqërisë personi si më poshtë, me afat 3 vjecar:
- Z. Jurgen Gorenca shtetas shqiptar, lindur më datë 01-05-1991 në Tiranë banues në Tiranë, mbajtës i pasaportës me Nr. BD2943763 dhe Nr. Personal J10501104W madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

- Specimeni i nënshkrimit:

- 8.2 Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm, në përputhje me parashikimet e nenit 95 të ligjit nr. 9901, datë 14 prill 2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", i ndryshuar dhe nenit 14 të Statutit.
- 8.3 Administratorit i jepen të gjitha kompetencat e nevojshme për të kryer të gjitha formalitetet dhe veprimet e parashikuara për themelimin e Shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi. Për këtë qëllim, Administratori, mund t'u drejtohet për ndihmë të tretëve ose konsulentëve të cilëve mund të delegojnë në tërësi ose pjesërisht kryerjen e aktivitetit të sipërpërmendur.
- 8.4 Administratori është gjithashtu i autorizuar të veprojë në emër të Shoqërisë në formim e sipër deri në regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Ai është gjithashtu i autorizuar, të firmosi të gjitha aktet dhe të marrë përsipër detyrime në emër të Shoqërisë që rrjedhin prej momentit të regjistrimit të saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe ka të drejtë t'i delegojë kompetencat e tij personave të tjerë.

## Neni 9 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 9.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin, zbatimin dhe zgjidhjen e këtij akti themelimi dhe të statutit të shoqërisë, si edhe ato që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve (përveç atyre personale apo jashtë Shoqërisë) ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.
- 9.2 Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ato do t'i besohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**Neni 10 – Gjuha**

10.1 Ky Akt Themelimi është hartuar në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe. Bashkëlidhur Statuti i Shoqërisë.

**ORTAKET**

**ADEA MEIDANI**

P/Jurgen Gorenca  
|—|—|—

**JURGEN GORENCA**

Jurgen Gorenca  
|—|—|—

**STATUTI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“PEGASE” Sh.p.k.**

**KAPITULLI I**  
**FORMA, EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA**

**Neni 1 – Forma**

- 1.1. Është themeluar shoqëria me përgjegjësi të kufizuar e quajtur “PEGASE” Sh.p.k., (në vijim “Shoqëria”), veprimtaria e së cilës rregullohet me anë të këtij Statuti.
- 1.2. Statuti i shoqërisë është në përputhje me legjislacionin shqiptar që ka karakter të detyrueshëm, ndërsa çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në të, plotësohen nga legjislacioni shqiptar në fuqi për shoqëritë tregtare.
- 1.3. Shoqëria ka vulën dhe logon e saj zyrtare.

**Neni 2 – Emërtimi**

- 2.1 Emërtimi i Shoqërisë është “PEGASE” Sh.p.k.

**Neni 3 – Objekti i shoqërisë**

- 3.1 Shoqëria ushtron aktivitetin e saj në fushën e konsulencës, kryesisht në tre drejtime kryesore; ndërmjetesime me karakter të ndryshëm; konsulencë juridike dhe teknike si dhe asistencë në projekte kundrejt subjekteve të ndryshme, qofshin ato ente publike, private, organizata noqeveritare apo entitete të huaja. Shoqëria do të japë konsulencës juridike në lidhje me çdo problematikë eventuale, në kuadër të specifikimit të kuadrit ligjor, pavarësisht fushës konkrete. Konsulencat në fjalë do të shtrihen edhe në fushën e legjislacionit fiskal, tatimor, doganor, duke përfshirë përgatitjen e dokumentacionit, ndjekjen e të gjitha procedurave për regjistrim të shoqërive deri në dhënien e licensës nga organi përkatës për fillimin e ushtrimit të aktivitetit;
- 3.2 Për më tepër, konsulencat juridike do të përfshijnë edhe marrëdhëniet tregtare, përpilim dhe depozitim dokumentesh të shoqërive tregtare të regjistruara si subjekte të së drejtës shqiptare apo të huaj; Konsulencë në distancë dhe me anë të përfaqësuesve të brendshëm; përfaqësim dhe orientimin e klientit për zgjidhjen gjyqësore të konflikteve; implementim në bashkëpunim me ente të tjera të projekteve në fushën e së drejtës që lidhen me përmirësimin e legjislacionit, asistencë në aplikimin e së drejtës, funksionimin e strukturave të dhënies së drejtësisë etj; Përfaqësimin dhe mbrojtjen ligjore të personave fizik dhe juridik, vendas apo të huaj, private apo publike, vendas apo të huaj, për çdo procedim administrativ, gjyqësor, jashtëgjyqësor, ekzekutimi të vendimeve gjyqësore etj. konform rregullave të parashikuara në legjislacionin në fuqi. Shoqëria mund të ushtrojë çdo lloji tjetër veprimtarie të lejueshme nga legjislacioni në fuqi si dhe të marrë pjesë në procedurat e prokurimeve publike dhe konçensioneve.

**Neni 4 – Selia**

- 4.1. Selia e Shoqërisë është në Rruga Themistokli Gërmenji, Njesia bashkiake nr.2, perballë RTSH, kati I, Tirane Shqiperi.
- 4.2. Transferimi i selisë së Shoqërisë në një vend tjetër bëhet me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme.
- 4.3. Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë hapjen e filialeve, degëve dhe

përfaqësive të Shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë edhe jashtë saj.

#### **Neni 5 – Kohëzgjatja e veprimtarisë**

- 5.1. Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar.
- 5.2. Shoqëria mund të priset përpara këtij afati me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

### **KAPITULLI II**

#### **KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE**

##### **Neni 6 – Kapitali themeltar**

- 6.1. Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 Lekë.
- 6.2. Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 2 kuota, i gjithi i nënshkruar dhe i paguar, me vlerë nominale sipas kontributit të ortakëve në kapitalin themeltar të Shoqërisë, përcaktuar në nenin 7 të këtij Statuti.

##### **Neni 7 – Kontributet dhe kuotat**

- 7.1. Kontributi në kapitalin e Shoqërisë është si më poshtë:
  - **Adea Meidani**, zotërues e një (1) kuote me vlerë të barabartë me 90 Lekë që përbën 90 % (nentedhete përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë;
  - **Jurgen Gorenca**, zotërues i një (1) kuote me vlerë të barabartë me 10 Lekë që përbën 10% (dhjete përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.

##### **Neni 8 – Rritja e kapitalit themeltar**

- 8.1. Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi në çdo moment, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
- 8.2. Zmadhimi i kapitalit mund të bëhet me derdhje në para ose me kontribute në natyrë.

##### **Neni 9 – Zvogëlimi i kapitalit themeltar**

- 9.1. Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.
- 9.2. Format dhe mënyrat e tjera të ushtrimit të drejtës në lidhje me rritjen dhe zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë do të bëhet sipas parashikimeve dhe lejlimeve të ligjit tregtar.

##### **Neni 10 – Transferimi i kuotave**

- 10.1. Kuotat janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve sipas përcaktimeve të ligjit për shoqëritë tregtare.
- 10.2. Në rast transferimi në çdo lloj forme, si me shpërblim ashtu edhe pa shpërblim në kuptimin më të gjerë të fjalës, duke përfshirë këtu edhe dhurimin në favor të subjekteve të tjerë të ndryshëm nga ortakët, kuotat duhet më parë t'i ofrohen në parablerje ortakëve të tjerë.
- 10.3. Në një rast të tillë ortaku që do të transferojë kuotën e tij duhet të njoftojë ortakët e tjerë, me letër rekomande me kthim përgjigje ose me email zyrtar të secilës prej palëve, mbi synimin për shitje, duke përcaktuar çmimin, kushtet, modalitetet, emrin e

blerësit dhe afatet e transferimit. E drejta e parablerjes duhet t'i referohet të gjithë kuotes të ofruar për shitje.

- 10.4 Ortakët do të kenë në dispozicion 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga marrja e letrës rekomande ose njoftimit me anë të emailit zyrtar të palëve, për t'i komunikuar ortakut që transferon kuotat, synimin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e parablerjes. Në rast se ata nuk përgjigjen në afatin e caktuar, prezumohet se kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes dhe transferimi i kuotës kryhet lirisht tek të tretët.
- 10.5 Në rast se oferta pranohet nga disa ortakë, kuota e ofruar nga ortaku që transferon ate, do të ndahet midis ortakëve pranues, proporcionalisht me vleren nominale të kuotes së kapitalit që ata zotërojnë, përveç rastit kur ka një marrëveshje të kundërt. Në asnjë rast, pranuesi i ofertës nuk mund të ushtrojë pjesërisht të drejtën e parablerjes.

### KAPITULLI III

#### ASAMBLEJA, ADMINISTRATORËT DHE EKSPERTI KONTABËL

##### Neni 11 – Asambleja e përgjithshme dhe kompetencat e saj

- 11.1 Organi vendim-marrës i Shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme.
- 11.2 Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështjet vijuese sipas përcaktimeve të ligjit për shoqëritë tregtare: ndryshimet e statutit, emërimi e shkarkimi i administratorëve, ekspertëve kontabël e likuidatorëve, zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit, transferimi i kuotave, shpërndarja e fitimeve, riorganizimi dhe prishja e shoqërisë, miratimi i bilancit dhe për çdo vendim tjetër parashikuar nga ky Statut apo nga legjislacioni përkatës në fuqi.

##### Neni 12 – Të drejtat e pjesëmarrjes dhe e votës

- 12.1 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në Asamble, të paraqesë mendimin e tij dhe të japë aq vota në proporcion me vleren nominale të kuotes së kapitalit që ai zotëron.
- 12.2 Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër, i pajisur me autorizim, me anën e së cilës mund të japë votën e tij.
- 12.3 Ortaku nuk mund të lëshojë prokurë për votim për një pjesë të kuotës që zotëron, në qoftë se voton personalisht për pjesën e mbetur.

##### Neni 13 – Thirrja e Asamblesë e Përgjithshme, Kuorumi dhe Vendimet

- 13.1 Asambleja e Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit, brenda gjashte muajve nga mbyllja e vitit financiar, për miratimin e bilancit, të raportit të Administratorit, ekspertit kontabël si dhe inventarit.
- 13.2 Asambleja mund të thirret në çdo moment nga një prej Administratorëve si dhe prej një ose disa ortakëve që përfaqësojnë të paktën 5% (pesë përqind) të kapitalit themeltar. Asambleja duhet të thirret nëpërmjet njoftimit me letër rekomande me kthim përgjigje që duhet t'u dërgohet ortakëve ose me poste elektronike dhe ekspertit kontabël (nëse është emëruar), të paktën 7 (shtatë) ditë përpara mbledhjes së Asamblesë. Thirrja duhet të përmbajë informacion mbi llojin e Asamblesë, mbi çështjet që do të trajtohen dhe për të cilat do të merret vendim, mbi vendin, orën dhe datën e thirrjes së parë dhe të dytë.
- 13.3 Asambleja mund të thirret edhe jashtë selisë së Shoqërisë.
- 13.4 Në rast se Asambleja e Ortakëve nuk mbledhet me thirjen e parë për mungesën e kuoromit të parashikuar në pikën 13.7 të këtij Statuti, Asambleja e Përgjithshme do të thirret brenda 30 (tridhjetë) ditësh me të njëjtin rend dite.

- 13.5 Mbledhjet e Asamblesë mund të mbahen edhe nëpërmjet telekonferencës dhe videokonferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe t'u lejohej atyre të ndjekin diskutimin dhe të ndërhyjnë në momentin e trajtimit të çështjeve në rend të ditës; pasi të jenë verifikuar këto kërkesa që duhet të rezultojnë në procesverbalin e mbledhjes, Asambleja konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari në të cilin duhet të ndodhet edhe Sekretari i mbledhjes.
- 13.6 Asambleja do të thirret dhe mbahet rregullisht edhe pa respektimin e formaliteteve të njoftimit, në rast se janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë të tërë kapitalin themeltar.
- 13.7 Vendimet e Asamblesë së Ortakëve, për të cilat kërkohet një shumicë e thjeshtë, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 30% (tridhjetë përqind) të kapitalit themeltar. Vendimet e Asamblesë së Ortakëve që kërkojnë një shumicë të cilësuar, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që zotërojnë të paktën 51% (pesedhjetënjë përqind) të kapitalit themeltar.
- 13.8 Asambleja e Ortakëve vendos ndryshimet e statutit, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, me votën pro të  $\frac{3}{4}$  (tre të katërtat) e ortakëve të pranishëm që zotërojnë të paktën 51% (pesedhjetë e një përqind) të kapitalit themeltar. Në të gjitha rastet e tjera, Asambleja e Ortakëve merr vendime me shumicë të thjeshtë votash të ortakëve që zotërojnë më shumë se 30% (tridhjetë përqind) të kapitalit themeltar.
- 13.9 Çdo Asamble drejtohet nga një ortak ose ndonjë person tjetër i caktuar nga vetë Asambleja. Për pasqyrimin e vendimit Asambleja emëron një Sekretar, që mund të jetë edhe jo-ortak.

#### Neni 14 – Administrimi

- 14.1 Shoqëria administrohet nga të paktën 1 (një) Administrator i cili do të qëndrojë në detyrë deri në shkarkim apo dorëheqje për një periudhë prej 5 (pesë) vitesh.
- 14.2 Përfaqësimi ligjor i Shoqërisë i besohet Administratorit. Administratori mund të ushtrojë të gjitha kompetencat konform me sa parashikohet në nenin 95 të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar. Veprimet të cilat tëjkalojnë objektin e kompetencës sipas këtij neni, janë të pavlefshme në qoftë se nuk kanë miratimin e të gjithë ortakëve.
- 14.3 Administratorët mund të emërojnë përfaqësues të posaçëm për veprime apo kategori të caktuara veprimesh.
- 14.4 Në rast se shoqëria administrohet më shumë se nga një administrator gjatë veprimtarisë së saj, administratorët mund të kenë kufizime tagrash bazuar në vendimin përkatës së Asamblesë së Përgjithshme. Këto kufizime do të pasqyrohen dhe do të bëhen të njohur dhe palëve të treta nëpërmjet regjistrimeve përkatëse.

#### Neni 15 – Eksperti kontabël i autorizuar

- 15.1 Në rast se kërkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e Përgjithshme, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabël të Shoqërisë mund t'i besohet një ose disa ekspertëve kontabël të autorizuar.
- 15.2 Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet në cdo kohe sipas mënyrës së parashikuar nga legjislati në fuqi.

### KAPITULLI IV

#### VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE

### Neni 16 - Viti financiar dhe bilanci vjetor

- 16.1 Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit.
- 16.2 Viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe përfundon më 31 dhjetor të të njëjtit vit.
- 16.3 Bilancet vjetore, inventari, raportet e Administratorit dhe ekspertit kontabël të autorizuar miratohen nga Asambleja me shumicën e kërkuar nga Ligji nt. 9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

### Neni 17 – Fitimet

- 17.1 Fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor, u shpërndahen ortakëve në proporcion me vleren nominale të kuotes së kapitalit themeltar të zotëruar.
- 17.2 Asambleja mund të vendosë edhe zbritje të veçanta në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo dhe shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare të ardhshme.

## KAPITULLI V

### SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË



### Neni 18 – Prishja

- 18.1 Shoqëria priset me përfundimin e afatit të parashikuar nga Statuti, ose përpara përfundimit në rastet e parashikuara nga ligji, ose me anë të një vendimi të Asamblesë së Përgjithshme, me shumicën e kërkuar për ndryshimet në statut.
- 18.2 Shoqëria nuk priset në rast të humbjes së zotësisë për të vepruar, vdekjes, ose falimentimit të ortakëve.

### Neni 19 – Likuidimi

- 19.1 Në rast prishje, Shoqëria duhet të likuidohet.
- 19.2 Për të administruar këtë procedurë, Asambleja emëron një ose më shumë likuidatorë, të cilët paraqesin raportet përfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të Shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.
- 19.3 Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja do të vendosë mbi bilancin financiar përfundimtar, mbi punën e kryer nga likuiduesi dhe mbi përfundimin e procesit të likuidimit.
- 19.4 Pas pagimit të kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori do t'i shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit ortakëve, në proporcion me vleren nominale të kuotes të zotëruar prej tyre në kapitalin themeltar.

### Neni 20 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 20.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij statuti si edhe ato që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve (përveç atyre personale apo jashtë Shoqërisë) ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.
- 20.2 Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ato do t'i besohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

1-1-

1-1-

**Neni 21 – Gjuha**

21.1 Ky Statut është hartuar në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

Nënshkruar më datë 28/12/2020

**ORTAK  
ADEA MEIDANI**

P/Jurgen Goranca

|—|—|—

**ORTAK  
JURGEN GORENCA**

Jurgen Goranca

|—|—|—





**VERTETIM**  
(Njesise me origjinali & Perktimi)

**CERTIFICATE**  
(Units with originality and translation)

Sot ne daten 28/12/2020 para meje noter Alket Mançka prane Dhomes se Noterise Tirane, Zyra Noteriale Tirane, Lagjia Nr. 2 ; Rruga " Asim Zeneli " Pll. Nr 10 ,u paraqit personalisht :

Today, On 28/12/2020 (two thousand twenty), in front of me Noter Alket Mancka, near the Tirana Notary Room, Tirana Notary Office, Neighborhood Nr. 2; Street "Asim Zeneli" Pl. No. 10, was presented personally:

Znj.ESA HALA, atesia Xhevdet, datelindje 13.01.1989, lindur dhe banuese ne Tirane, identifikuar me karte identiteti me Nr.035050142 dhe Nr.Personal I95113032R , madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, e cila kerkoi vertetimin e njesise me origjinalin dhe perkthimin e Dokumentit origjinal bashkangjitur.

MRS.ESA HALA, daughter of Xhevdet , birthday 13.01.1989, born and resident in Tirana, holder of identity card with No.035050142 and Personal No.I95113032R , adult with full capacity to act, personally known by me, who requested the authentication of the unit with the original and the translation of the original attached Document.

- Une noteri pasi e verej se dokumenti i fotokopjuar eshte i njejte me origjinalin konstatoj se nuk ka korigjime, shtese, fshirje, apo shenja te tjera te vecanta ne baze te nenit 62 te Ligjit 110/2018 date 20.12.2018 "per Noterine (i ndryshuar) dhe Udhezimit nr. 6291 date 17.8.2005 pika 7 e Ministrit te Drejtesise e vertetoi njesine: E njejte me Origjinalin.
- Gjithashtu une noter Alket Mançka ne baze te Ligjit 110/2018 date 20.12.2018 (i azhomuar me ndryshimet perkatese) "Per Noterine" deklaroi se perkthimi i dokumentave bashkangjitur ketij Vertetim perkthimi nga gjuha Franceze ne gjuhen Shqipe eshte bere prej Znj.ILIRA ELBASANI, perkthyes zyrtare e njohur nga Ministria e Drejtësisë, me Nr.Personal I15212110T dhe eshte konform origjinalit.
- I noticed after noticing that the photocopy document is the same with the original ascertain that there are no corrections, additions, deletions, or other special signs under Article 62 of Law 110/2018 dated 20.12.2018 "Notary (as amended) and Guideline no. 6291 dated 17 August 2005, point 7 of the Minister of Justice certifies the unit: The same as the original.
- Also, I, the notary Alket Mancka pursuant to Law 110/2018 dated 20.12.2018 (as amended by the respective amendments) "For Notary", stated that the translation of the documents attached to this Certificate of Translation from French to Albanian was conducted by Mrs.ILIRA ELBASANI, official translator recognized by the Ministry of Justice , with personal No.I15212110T, and it is in conformity with the original.

NOTER/PUBLIC NOTARY  
ALKET Z. MANÇKA



## POUVOIR

**Madame Adea Meidani**  
**Demeurant 145 Avenue Malakoff**  
**Née à Tirana, Albanie le 27 avril 1981**  
**De nationalité française**

donne par les présentes pouvoir à

**Monsieur Jurgen Gorenca**  
**Rruga Besim Imami nr 86, Tirana, Albania,**  
**Né le 1<sup>er</sup> mai 1991**  
**De nationalité albanaise**

à l'effet de

- signer en son nom et pour son compte les statuts de la Société Pegase (ou similaire si ce nom n'est pas disponible), avec la répartition de capital suivante : 90% pour Adea Meidani et 10% pour Jurgen Gorenca,
- signer en son nom et pour son compte l'acte de nomination du gérant, Jurgen Gorenca, de la Société Pegase comme gérant de celle-ci,
- signer tout document relatif à la constitution de la Société et toute formalité.

Adresse de la société : Rruga Themistokli Ghermenji, Njesia bashkiake nr.2, perballë Rr. Shqipëri, kati I, Tirane Shqiperi

Objet de la société : activité de conseil

Le présent pouvoir vaut autorisation au sens des dispositifs albanais en la matière.

Le 9 décembre 2020

Bon pour pouvoir



Le Mandant

(Faire précéder la signature de la mention manuscrite « bon pour pouvoir »)

Je soussigné M. Yvon GERARD  
notaire avoué à Paris certifie  
que la signature apposée ci-dessus  
est celle de Melle ADEA MEIDANI

Paris le 9 décembre 2020



1



### APOSTILLE

(Convention de La Haye du 5 octobre 1961)

ALBANIE

- 1. République française
- Le présent acte public
- 2. a été signé par Me Yvon GERARD
- 3. agissant en qualité de Notaire
- 4. est revêtu du sceau/timbre de De son étude



Attesté

- 5. à Paris
- 6. le 21 DEC. 2020
- 7. par le Procureur général près la Cour d'Appel de Paris
- 8. sous n° 17897-B
- 9. Scellé : Michel LERNOUT  
PREMIER AVOCAT GENERAL



"L'apostille confirme seulement l'authenticité de la signature, du sceau ou timbre sur le document. Elle ne signifie pas que le contenu du document est correct ou que la République française approuve son contenu"

## PROKURË

Znj. Adea Meidani  
Banuese në 145 Avenue Malakoff  
Lindur në Tiranë, Shqipëri, më 27 prill 1981  
Me shtetësi franceze

me anë të kësaj prokure i jep

Z. Jurgen Gorenca  
Rruga Besim Imami nr. 86, Tiranë, Shqipëri,  
Lindur më 1 maj 1991  
Me shtetësi shqiptare

kompetencat për të

- nënshkruar në emër të dhe për llogari të saj statutet e Shoqërisë Pegase (ose të ngjashëm nëse ky emër nuk është i disponueshëm), me ndarjen vijuese të kapitalit : 90% në pronësi të Adea Meidani dhe 10% në pronësi të Jurgen Gorenca,
- nënshkruar në emër të dhe për llogari të saj aktin e emërimit të menaxherit, Jurgen Gorenca, të Shoqërisë Pegase në cilësinë e menaxherit të kësaj të fundit,
- nënshkruar të gjitha dokumentet që lidhen me themelimin e Shoqërisë dhe të gjitha formaliteteve të tjera.

Adresa e shoqërisë: Rruga Themistokli Gërmenji, Njësia bashkiake nr.2, përballë RTSH, kati I, Tiranë, Shqipëri

Objekti i shoqërisë : veprimtari konsulence

Kjo prokurë është ekuivalente me autorizimin sipas kuptimeve të rregulloreve shqiptare në fuqi.

Më 9 dhjetor 2020

Unë, i nënshkruari Z. Yvon GERARD  
noter i asociuar në Paris certifikoj  
nënshkrimin e mësipërm dhe nënshkrimin  
e Adea Meidani.

(nënshkrimi dhe vula)

Paris, më 9 dhjetor 2020

*Vlen si prokurë*

(nënshkrimi)

**Kërkuesi**

**(Paraprin nënshkrimin me dorë vlen si prokurë)**



**APOSTILE**  
(Konventa e Hagës e datës 5 tetor 1961)

1. Shteti: **Republika franceze**

Ky dokument publik

2. nënshkruhet nga: **Z. Yvon GERARD**

3. i cili vepron në cilësinë e: **Noterit**

4. mban vulën/ pullën e: **Noterit**

**Certifkohet**

5. në: **Paris**

6. më: **21 dhjetor 2020**

7. nga: **Prokurori i Përgjithshëm i Gjykatës së Apelit, Paris**

8. nr.: **17897-B**

9. Vula/pulla:

10. Nënshkrimi:

**Michel LERNOUT**  
Avokat i parë i përgjithshëm

(nënshkrimi dhe vula)

